

Mbrojtja e liderëve të UÇK-së  
ankohet në Apel për disa  
prova, kritikon vendimet e  
gjyqtarëve të Speciales



FAQE 10

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"



**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

DËSHTON EDHE PËRPPJEKJA E 50 PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT TË KOSOVËS

## VAZHDON BLLOKADA NË KUVEND, PALËT NUK LËSHOJNË PE

FAQE 4-5

**- Kurti: Këtë fundjavë do ta kemi lajmin për arritjen ose jo të një marrëveshjeje për institucionet**



Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në përpjekjen e 50. Deputetët nuk janë duke arritur pajtueshmëri për mënyrën e zgjedhjes së kryeparlamentarit të ri. IV-ja është duke insistuar që kryeparlamentari të zgjedhet me

votim të fshehtë, ndërsa PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja janë duke kërkuar që shefi i Kuvendit të votohet në mënyrë të hapur siç ka ndodhur në tetë legjislaturat e kaluara. Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se janë të gatshëm

për bashkëqeverisje me Nismën e Fatmir Limajt, duke bërë me dije se i ka bërë ofertë konkrete. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se në "këtë fundjavë do ta kemi lajmin për arritjen ose jo të një marrëveshjeje për institucionet"

**KOSOVA  
I KONSIDERON  
KËRCËNUESE  
DEKLARATAT E  
VUÇIQIT PAS  
ARRËSTIMIT TË  
ZYRTARIT SERB**

F. 5



**RIKONFIRMOHET  
THELLIMI I  
BASHKËPUNIT  
NDËRMJET  
USHTRIVE  
KOSOVË -  
SHQIPËRI**

F. 3



**EKONOMISTËT: KOSOVA TA HEQË  
TAKSËN NDAJ SHBA-SË, DËMTON  
EKONOMINË DHE MARRËDHËNIET  
DIPLOMATIKE**

F. 8

**DOGANA TEJKALON 1 MILIARD  
EURO TË HYRA, RRRITJE  
PREJ 9.7-PËRQINDËSH  
ME VITIN E KALUAR**

F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Magedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**SPORT**

**HEDHET SHORTI PËR SEZONIN E RI NË  
FUTBOLL**

F. 10

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Beduinët evakuhohen nga provinca me shumicë druze në Siri

**SUVEIDA, 21 KORRIK** - Qindra civilë beduinë janë evakuuar nga qyteti Suveida, i banuar kryesisht nga druzët, në kuadër të një marrëveshjeje të ndërmjetësuar nga Shtetet e Bashkuara për dhënie fund të luftimeve, që kanë lënë të vrarë qindra persona, kanë raportuar mediet shtetërore dhe dëshmitarët.

Dhuna në provincën jugore Suveida është përshkruar si test i madh për presidentin e përkohshëm sirian Ahmedal-Sharaa, pasi ndërkohë kanë nisur edhe sulmet ajrore izraelite, duke thelluar ndasitë në këtë shtet të shkatërruar që 14 vjet luftë.

Armëpushimi është zbatuar të dielën, teksa forcat e sigurisë janë pozicionuar në paralagje të Suveidas.

Ministri i Brendshëm sirian, Anas Khattab, ka thënë të dielën se armëpushimi do të

mundësojë lirin e pengjeve dhe të ndaluarve që mbahen nga të dyja palët.

Në mëngjesin e së hënës, ambulancat, kamionët dhe autobusët me qindra beduinë civilë janë larguar nga Suveida për në kampe të afërta.

Në grupin e parë janë shpërngulur 300 beduinë, ndërsa grupi i dytë me 550 beduinë do të evakuhet brenda 24 orëve, nëse situata vazhdon të jetë e qetë, kanë thënë autoritetet e sigurisë që po mbikëqyrin procesin.

Agjencia shtetërore e lajmeve e Sirisë ka thënë se në total do të evakuhohen 1 500 beduinë nga Suveida. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, të paktën 93 000 persona janë detyruar të largohen nga provinca Suveida apo rajone të afërta me të si pasojë e luftimeve. OKB-ja ka thënë të



dielën se konvojet humanitare me furnizime mjekësore janë në pritje për të hyrë në Suveida që dy ditë, mirëpo nuk u është lejuar qasja.

Sipas organizatës, në provincë ka mundur të hyjë vetëm një konvoj i Gjysmëhënës së Kuqe. Druzët janë minoritet i vogël,

por me ndikim në Siri, Izrael dhe Liban, të cilët ndjekin një fe, e cila, sipas tyre, është degë e Islamit. Disa myslimanë sunitë ultra-konservatorë i konsiderojnë besimet druze si heretike.

Duke përmendur synimin e mbrojtjes së duzeve dhe

mbajtjes së jugut të Sirisë të çmilitarizuar, Izraeli i ka sulmuar forcat qeveritare javën e kaluar në jug, ashtu sikurse Ministrinë e Mbrojtjes në Damask. Uashingtoni, i cili ka ofruar mbështetje për Damaskun, prej kur Sharaa është takuar me presidentin amerikan Donald Trump në maj, ka thënë se nuk i ka miratuar sulmet izraelite.

Luftimet kanë nisur javën e kaluar me përlëshje mes beduinëve dhe luftëtarëve druzë.

Damasku i ka dërguar trupat e veta për t'i ndaluar luftimet, mirëpo ata vetëm çka janë përfshirë në dhunë dhe janë akuzuar për shkelje kundër druzëve.

Presidenti i përkohshëm al-Sharaa është zotuar për t'i mbrojtur të drejtat e druzëve dhe për t'i mbajtur përgjegjës ata që kanë kryer shkelje.

## Vendet perëndimore koordinojnë armatimin e Ukrainës

**KIEV, 21 KORRIK** - Anëtarët e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës (UDCG), të kryesuar nga Mbretëria e Bashkuar dhe Gjermania, do të takohen për të diskutuar planet e presidentit të ShBA-së, Donald Trump, që aleatët e NATO-s t'i sigurojnë Ukrainës armë.

UDCG, i njohur edhe si formati Ramstein vjen pasi Trumpi ka thënë se dërgesat e armëve, duke përfshirë sistemet e mbrojtjes ajrore Patriot, mund të mbërrijnë në Ukrainë brenda ditësh. Trumpi javën e kaluar ka treguar se ka nënshkruar një marrëveshje me aleatët e NATO-s që do të çonte në dërgesa armësh në shkallë të gjerë në Ukrainë, duke përfshirë sistemet "Patriot", të konsideruara si një nga më të mirat në botë për zbulimin dhe kapjen e një game të gjerë objektivash ajrore që vijnë. "Ne do të dërgojmë 'Patriot' në NATO dhe më pas NATO do t'i



shpërndajë ato. Aleanca do të paguajë për sistemet", ka thënë Trumpi.

Presidenti amerikan, duke folur me shefin e NATO-s, Mark Rutte, ka thënë se armët do të paguheshin nga aleatët evropianë dhe se dërgesat fillestare do të

mbërrijnë "brenda disa ditësh". Kuptohet që kombet evropiane do t'i transferojnë armët të mbledhura nga rezervat ekzistuese ose nga ato të reja të blera nga ShBA-ja, në Ukrainë. Zëvendësimet do të blihen nga ShBA-ja.

Nuk është ende e qartë nëse janë bërë transferime armësh në Ukrainë, me komandantin Suprem të Forcave Aleate të NATO-s për Evropën, gjeneralin Alexis Grynkeuich, i cili ka thënë se përgatitjet për dorëzimin e armëve ishin "në proces".

Ambasadori i ShBA-së në NATO, Matthew Whitaker, ka thënë se nuk mund të jepte një afat kohor. Ndërsa kancelari gjerman Friedrich Merz ka thënë se ishte i bindur se Gjermania së shpejti do të arrinte një marrëveshje me ShBA-në për dorëzimin e "Patriotëve".

"Negociatat midis ministrave të mbrojtjes ishin konkrete dhe dorëzimi i tyre ishte çështje ditësh, ndoshta javësh", ka thënë Merz.

Është raportuar se Forcat e Armatosura të Gjermanisë, Bundeswehr, do të dorëzojnë dy nga nëntë sistemet e saj të mbetura "Patriot" dhe do të

marrin zëvendësime nga ShBA-ja. Ky veprim vjen pavarësisht planeve fillestare për të blerë dy sisteme "Patriot" nga ShBA dhe për t'i dërguar ato direkt në Ukrainë.

Sisteme të tjera mund të dorëzohen nëpërmjet Zvicrës, Ministria e Mbrojtjes e së cilës ka njoftuar se ishte informuar nga Departamenti i Mbrojtjes i ShBA-së për të "ripërcaktuar përparësitë e dorëzimit" të pesë sistemeve të porositura më parë për të mbështetur Ukrainën. Një zyrtar i lartë i NATO-s, ka deklaruar se aleanca është duke koordinuar dorëzimin e mbështetjes shtesë ushtarake, duke përfshirë municione dhe predha artilerie, ndërsa Ukraina pret mbërritjen e sistemeve "Patriot". Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka njoftuar se zyrtarët e tij kanë propozuar një raund të ri bisedimesh për paqe që do të zhvillohen këtë javë.

## Ekuadori ekstradon në ShBA trafikantin më të madh të drogës

**QUITO, 21 KORRIK** - Qeveria e Ekuadorit e ka ekstraduar të dielën trafikantin më të madh të drogës, Adolfo Macias, të njohur me nofken "Fito" në Shtetet e Bashkuara, një muaji pasi ka rënë në duart e autoriteteve.

Më 2024, ai pati ikur nga një burg i sigurisë së lartë. Zyra e Prokurorit në Shtetet e Bashkuara e ka publikuar aktakuzën kundër tij në prill. I

përshkruar si kreu i bandës "LosChoneros", Macias akuzohet për shpërndarje të kokainës, për komplot dhe dhunë me armë, përfshirë kontrabandë të armëve. Në një letër të lëshuar nga Departamenti amerikan i Drejtësisë është thënë se Macias do të paraqitet në gjykatën federale të hënën. Ky shtetas ekuadorian, dikur një shofer taksie, por i shndërruar në bos

krimi, është pajtuar në gjykatë një javë më parë që të ekstradohet në Shtetet e Bashkuara për t'u përballur me akuzat. Ai është shtetasi i parë i Ekuadorit që ekstradohet nga vendi i tij prej hyrjes në fuqi të ligjit të ri një vit më parë. Ligji është miratuar pas një referendumi të mbajtur nga presidenti Daniel Noboa me qëllim të sigurimit të mbështetjes për t'i luftuar bandat kriminale.



# MBROJTJA E LIDERËVE TË UÇK-SË ANKOHET NË APEL PËR DISA PROVA, KRITIKON VENDIMET E GJYQTARËVE TË SPECIALES



**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Pasiguri, konfuzion e kundërshtime të vetvetes. Varësisht se për cilën palë bëhet fjalë dhe për të njëjtën çështje ligjore, gjyqtarët japin vendime të ndryshme. Ky është konstatimi i mbrojtjes së liderëve të UÇK-së lidhur me disa prova materiale që janë pranuar në proces gjyqësor ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit. Si rezultat, ankesa e mbrojtjes është dërguar në Gjykatën e Apelit.

Në parastresë mbrojtja është ankuar për disa prova e raporte të pranuar nga disa dëshmitarë ekspertë, raporte nga organizata ndërkombëtare dhe disa artikuj të tjerë.

Sipas ankesës, avokatët e liderëve të UÇK-së kanë theksuar se nuk kanë pasur mundësi t'i kundërshtojnë këto prova dhe se Zyra e Prokurorit të Specializuar

(ZPS) ka pasur mundësinë të heqë këta dëshmitarë nga lista dhe në vend të kësaj të kërkonte vetëm pranimin e raporteve. “Së dyti, interpretimi i Panelit nuk mund të ketë qenë qëllimi i hartuesve të rregullave. Hartuesit nuk mund të kenë pasur për qëllim t'ia lënë një pale ofertuese fuqinë për të kontrolluar zbatueshmërinë e Rregullës 149, duke u lejuar atyre, sipas tekave të tyre, t'i mohojnë Palës kundërshtare përfitimin e mbrojtjeve që ajo ofron. Në bazë të Rregullës 149, palët kanë të drejtë për më shumë mbrojtje ligjore kur bëhet fjalë për pranimin e provave të ekspertëve. Provat e ekspertëve trajtohen ndryshe në juridiksionet vendase dhe ndërkombëtare njësoj për një arsye të mirë; kjo është arsyeja pse ekziston një ‘lexspecialis’. Provat e ekspertëve nuk janë më pak prova të ekspertëve kur

paraqiten me shkrim sesa kur dëgjohen drejtpërdrejt. Hartuesit e rregullave nuk mund të kishin për qëllim që pala thirrëse të mund të zgjidhte thjesht të paraqiste prova të ekspertëve të pakontestueshme përmes tryezës së avokatëve, ose t'i përdorte ato si ‘material burimor’ nëse dhe kur të dojë, në vend që të vepronte përmes dispozitave të Rregullës 149. Kjo është thelbësisht në kundërshtim me interesat e drejtësisë”, është thënë në ankesë.

Mbrojtja e krerëve të UÇK-së ka kritikuar ashpër vendimet që janë duke marrë gjyqtarët, duke theksuar se janë duke e kundërshtuar vetveten. “Të akuzuarit dhe palët kërkojnë siguri ligjore. Rezultati përfundimtar i qasjes së ndryshme të Panelit ndaj të njëjtës çështje ligjore, bazuar, me sa duket, në atë se kush

është pala që bën thirrjen, ka krijuar pasiguri dhe konfuzion. Nuk mund të jetë e saktë si çështje ligjore që standardet përkatëse të zbatueshme për pranimin e provave të ekspertëve varen nga ajo se kush është pala që bën thirrjen, veçanërisht kur vetë Rregulli 149 nuk bën një dallim të tillë. Paneli ka kundërshtuar veten duke krijuar standarde ligjore dhe pasiguri ligjore divergjente për të gjithë në këtë rast”, është thënë në këtë ankesë.

Avokatët kanë pasur kritika edhe për mënyrën se si janë pranuar disa raporte të patologëve mjeko-ligjorë dhe autopsitë që kanë hartuar ata. “Paneli i përshkroi në mënyrë të papërshtatshme raportet e ekspertëve në fjalë si ‘dokumente autopsie dhe dokumente të tjera në lidhje me vdekjen e viktimave, në atë që duket të jetë një përpjekje

për ta zbehur gabimisht statusin e tyre si raporte ekspertësh. Nuk mund të ketë asnjë mosmarrëveshje të arsyeshme se patologët mjeko-ligjorë që shkruan këto raporte nuk janë dëshmitarë në këtë rast; ata panë dhe ekzaminuan trupat e viktimave të dyshuara në këtë rast, regjistruan gjetjet e tyre, zbatuan ekspertizën e tyre dhe dhanë përfundimet e tyre që rezultuan. Këto raporte janë raporte ekspertësh sipas kuptimit të Rregullës 149 dhe, siç u përshkrua më sipër, të gjitha raportet e ekspertëve në të cilat mbështetet një palë duhet t'u nënshtrohen dispozitave të ‘lexspecialis,’ Rregullës 149”, është thënë në ankesën e avokatëve të liderëve të UÇK-së.

Si rezultat, avokatët kanë kërkuar që Apeli ta pranojë ankesën dhe t'i rrëzojë këto vendime të cilat kanë interpretime të gabuara.

Kujtojmë se më 16 korrik Gjykata Speciale në Hagë ka refuzuar plotësisht mocionin e mbrojtjes që kërkonte heqjen e disa fakteve materiale nga aktakuzat ndaj liderëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi. Mocioni kishte për qëllim ta sfidonte përfshirjen e ngjarjeve që kanë ndodhur para majit të vitit 1998 dhe pas 20 qershorit 1999.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi ndodhen në qendrën e paraburgimit në Hagë që nga nëntori i vitit 2020. Ata kanë bërë disa herë kërkesa për lirim me kusht, por nuk janë marrë parasysh nga Gjykata Speciale.

Që nga fillimi i procesit gjyqësor janë larguar disa nga avokatët kryesorë për shkak të çështjeve financiare. Për këtë çështje janë kritikuar ashpër institucionet e Kosovës të cilat që nga fillimi i këtij procesi gjyqësor janë duke u drejtuar nga Lëvizja Vetëvendosje.

## Rikonfirmohet thellimi i bashkëpunimit ndërmjet ushtrive Kosovë - Shqipëri

**TIRANË, 21 KORRIK** - Në kuadër të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSh), një delegacion nga Komanda e Logjistikës (KL) së FSK-së, kryesuar nga zëvendëskomandanti i KL-së, kolonel Mehmet Lladrovci, ka realizuar një vizitë zyrtare pranë Komandës Mbështetëse dhe strukturave vartëse të saj në

FARSh. Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka njoftuar se gjatë kësaj vizite janë zhvilluar takime në fushën logjistike, ku delegacioni nga Kosova është pritur nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneralbrigade Aleksandër Pando dhe stafi i tij dhe në fushën shëndetësore janë pritur nga zëvendëskomandanti i Komandës së Forcave Tokësore, gjeneralbrigade Vehbiye Kuti dhe ushtruesi i detyrës së drejtorit të

Inspektoratit Shëndetësor të FARSh-it, nënkolonel Marinela Mjeda. “Në kuadër të këtyre takimeve delegacioni nga FSK u informua në detaje rreth strukturës, kapaciteteve logjistike dhe atyre shëndetësore të FARSh-it, si dhe biseduan për mundësitë e bashkëpunimit dhe për shkëmbimin e përvojave duke rikonfirmuar përkushtimin për ta thelluar bashkëpunimin ndërmjet dy ushtrive”, ka njoftuar FSK-ja.





DËSHTON EDHE PËRPPJEKJA E 50 PËR KONSTITUIMIN E KUVENDIT TË KOSOVËS

# VAZHDON BLLOKADA NË KUVEND, PALËT NUK LËSHOJNË PE

**- Kurti: Këtë fundjavë do ta kemi lajmin për arritjen ose jo të një marrëveshjeje për institucionet**

Kuvendi i Kosovës nuk është konstituuar as në përpjekjen e 50. Deputetët nuk janë duke arritur pajtueshmëri për mënyrën e zgjedhjes së kryeparlamentarit të ri. LV-ja është duke insistuar që kryeparlamentari të zgjedhet me votim të fshehtë, ndërsa PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja janë duke kërkuar që shefi i Kuvendit të votohet në mënyrë të hapur siç ka ndodhur në tetë legjislaturat e kaluara. Kryetari i LV-së, Albin Kurti, ka thënë se janë të gatshëm për bashkëqeverisje me Nismën e Fatmir Limajt, duke bërë me dije se i ka bërë ofertë konkrete. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se në “këtë fundjavë do ta kemi lajmin për arritjen ose jo të një marrëveshjeje për institucionet”

më 25 (korrik), të kemi një interpretim të ri nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Por, një interpretim e kemi, ashtu siç kemi edhe një mosrespektim të tij, që do të thotë se kemi një përmbyesje të rendit kushtetues. Do të shohim se si do të procedohet tutje, por është e qartë se pas 30 ditëve, nëse ky Kuvend nuk konstituohet, i ka huqur afatet e përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese dhe duhet një interpretim i ri, sepse as Gjykata nuk e ka përcaktuar se çfarë do të ndodhë në të ardhmen’.

## Kush është për dhe kundër Limajt?

Kuvendi nuk është konstituuar as pas një takimi të zhvilluar të shtunën e javës së kaluar mes kryeministrit në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, njëherësh kryetar i Lëvizjes Vetëvendosje, me kryetarin e Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj. Hollësitë e takimit nuk janë bërë të ditura. Deputetja e Nismës, Xhevahire Izma, ka deklaruar

paraprakisht se partia së cilës i takon ajo kërkon që Limaj të propozohet për kryetar Kuvendi. Ndërsa deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kanë përsëritur të hënën se nuk kanë votë për Limajn për kryetar Kuvendi. “Në asnjë rrethanë Limaj nuk do të votohet nga Aleanca. E mira është që këta dy liderë (Kurti e Limaj) kanë rënë dakord për t’u takuar prapë. Janë bërë sikur Burdushi - shihemi në takimin tjetër, se nuk ka diçka konkrete prej tyre”, ka thënë deputeti Lahi Brahimaj.

Për dallim prej tyre, kryetari i partisë serbe për Liri, Drejtësi dhe Mbijetesë, Nenad Rashiq, njëherësh ministër në detyrë për Komunitete dhe Kthim i Kosovës, ka thënë se nëse Lëvizja Vetëvendosje propozon Limajn për kryetar, ai do të votonte për. Deputetë të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) kanë thënë në të kaluarën se nuk e votojnë asnjë kandidat që ka mbajtur pozita ministrore në të kaluarën. Situata është bllokuar pasi PDK-ja, LDK-ja, AAK-ja dhe Lista Serb nuk janë duke pranuar të propozojnë nga një kandidat për formim të një komisioni për votim të fshehtë, me arsyetimin se mënyra e ndryshimit të votimit është jokushtetuese. Lëvizja Vetëvendosje është duke kërkuar që Albulena Haxhiu, e propozuar për kryeparlamentare, të votohet vetëm një herë përmes votimit të fshehtë dhe nëse nuk i siguron 61 votat e nevojshme, ajo do të tërhiqet nga

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

Prishtinë, 21 korrik - Deputetët nuk arritur as për herën e 50 ta konstituojnë Kuvendin e Kosovës pavarësisht prej zërave se në fundjavën e kaluar ishte paralajmëruar se do të mund të arrihej një marrëveshje për zhbllokim të situatës. Të pranishëm në vazhdimin e seancë të hënën kanë qenë 104 deputetë.

Bashkëkryetari i partisë Guxo, Faton Peci, ka thënë se partia e tij, në koalicion me Lëvizjen Vetëvendosje dhe Alternativën, kanë bërë shumë përpjekje për konstituim të Kuvendit, dhe u ka bërë thirrje të gjithë deputetëve për të reflektuar mbi situatën e krijuar. “Përpjekjet vazhdojnë. Kryeministri në detyrë ka pasur ofertë konkrete për disa parti politike. Aktualisht ka dhënë ofertë për Nismën

Socialdemokrate, ndërsa në një fazë më të hershme ka pasur ofertë për të diskutuar për bashkëqeverisje me Lidhjen Demokratike të Kosovës”, ka thënë Peci para gazetarëve. Palët vazhdojnë të mos gjejnë kompromis ndonëse po ecën afati i përcaktuar nga Gjykata Kushtetuese për konstituim të Kuvendit.

Kushtetuesja e ka përcaktuar 26 korrikun afat të fundit për konstituim, por nuk ka ofruar më shumë hollësi se çfarë ndodh më tutje nëse partitë nuk merren vesh deri atëherë. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka paralajmëruar se do t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese këtë javë. Pas seancës, lideri i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se nuk pret ndonjë zgjidhje as në ditët e mbetura. “Ajo që pritët është që pas afatit 30-ditor, që përfundon

## Kurti: Të gatshëm për bashkëqeverisje me Nismën, i kemi bërë ofertë konkrete.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministër në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se partia e tij ka gatishmëri për të bashkëqeverisur me Nismën Socialdemokrate të Fatmir Limajt, parti së cilës ka bërë me dije se i ka bërë ofertë konkrete. “Me Limajn kemi zhvilluar një takim pardje. LV-ja dhe unë kemi shprehur interesimin dhe gatishmërinë për të bashkëqeverisur me Nismën Socialdemokrate dhe në përputhje me këtë unë kam bërë edhe një ofertë konkrete që gjithçka të përmbyllet sa më shpejt e

mirë, të kemi konstituim të Kuvendit dhe qeverinë”, ka thënë Kurti në një konferencë për medie në Qeverinë e Kosovës. Kurti ka thënë se nuk mund të ofrojë hollësi pasi kjo ofertë ende nuk është konkretizuar në marrëveshje, duke theksuar se “nevojitet të vazhdojnë bisedimet dhe vullneti politik” në mënyrë që të krijohen institucionet e reja. Më tutje, Kurti ka thënë se shpreson që bisedimet me partinë e Limajt të finalizohen gjatë kësaj jave. “Këtë fundjavë do ta kemi lajmin për marrëveshjen e arritur ose mungesën e saj”, ka thënë Kurti.

# KOSOVA I KONSIDERON KËRCËNUESE DEKLARATAT E VUÇIQIT PAS ARRESTIMIT TË ZYRTARIT SERB

PRISHTINË, 21 KORRIK - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se deklaratat e bëra nga presidenti serb Aleksandër Vuçiq, pasi Kosova i ka shqiptuar një muaj paraburgim një zyrtari qeveritar serb, janë kërcënuese dhe nuk duhen neglizhuar pasi, sipas tij, rrezikojnë sigurinë e rajonit. “Deklaratat e presidentit Vuçiq të bëra më 20 korrik janë kërcënuese, destabilizuese dhe krejtësisht të papranueshme. Kur një president dhe njëkohësisht komandant suprem i ushtrisë së një shteti lëshon kërcënime publike, me tone nxitëse të konfliktit, kjo nuk mund të konsiderohet më si qëndrim individual, por politikë shtetërore”, ka thënë Kurti të hënën në një konferencë për medie. Vuçiqi të dielën mbrëma e ka paralajmëruar Kosovën për “pasoja të paparashikueshme”, pasi Gjykata Themelore në Prishtinë i caktoi një muaj paraburgim Igor Popoviqit, ndihmësdrejtorit të Zyrës për

Kosovën në Qeverinë serbe. “Arrestimi i fundit i Igor Popoviqit tregon se Albin Kurti e ka humbur arsyen dhe se dëshiron të shkaktojë incidente dhe konflikte në Ballkanin Perëndimor”, ka thënë ai. Popoviqi dyshohet për veprën penale “nxitje e përçarjes dhe mosdurimit”. Kurti i ka bërë thirrje bashkësisë ndërkombëtare “të reagojë qartë dhe me vendosmëri ndaj kërcënimeve të Vuçiqit”, duke shtuar se deklaratat të tilla mund ta destabilizojnë të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Po ashtu, Kurti u ka bërë thirrje qytetarëve të Kosovës ta shmangin udhëtimin përmes Serbisë pasi, sipas tij, “ka indikacione” për provokime dhe ndalime arbitrare të qytetarëve të Kosovës. “Nuk jemi të frikësuar nga retorika e Vuçiqit, por jemi të vendosur për t’i mbrojtur ligjin, rendin dhe demokracinë tonë”, ka thënë Kurti. Igor Popoviq është ndaluar më 18 korrik në Kosovë pasi, sipas autoriteteve në Kosovë, gjatë



një fjalimi në Hoqë të Madhe ai e ka cilësuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) “organizatë terroriste” dhe i ka krahasuar veprimet e saj me ngjarje të rënda

ndërkombëtare. Pas këtij fjalimi në Rahovec, ai është ndaluar në pikën kufitare në Bërnjak dhe është dërguar në mbajtje policore, ndërsa më 20 korrik ndaj tij

është shqiptuar masa e paraburgimit prej 30 ditësh. Kundër pranisë së Popoviqit në Kosovë janë shprehur edhe kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së./REL

## Osmani dhe Orav diskutojnë për çështjen e konstituimit të Kuvendit dhe raportet Kosovë-BE



PRISHTINË, 21 KORRIK - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur në takim shefin e zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, Aivo Orav, me të cilin ka diskutuar rreth situatës aktuale politike në vend dhe zhvillimeve të fundit. Në fokus të takimit ishte

çështja e konstituimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, hapat e mëtejshëm, ndikimi i moskonstituimit në proceset e rëndësishme për vendin, si dhe në raportet me Bashkimin Evropian. Presidentja Osmani dhe ambasadori Orav, kanë diskutuar gjithashtu për një

sërë çështjesh që ndërlidhen me raportet ndërmjet Kosovës dhe BE-së, ku presidentja ka theksuar rëndësinë e heqjes së plotë të masave të padrejta ende në fuqi, si dhe të trajtimit të aplikacionit të Kosovës për marrjen e statusit të vendit kandidat.

gara. Haxhiu nuk i ka siguruar votat e nevojshme në disa seanca radhazi që janë mbajtur me votim të hapur. Për disa parti ajo është figurë përçarëse dhe e papranueshme. Para vazhdimit të seancës, avokati Arianit Koci të hënën ka qethur kokën para Kuvendit, duke thënë se ky është akt simbolik përmes të cilit po dëshmon se “ka ardhur fundi”. “Kjo nuk është më politikë, prandaj kërkoj që menjëherë sot të formohet Kuvendi”, ka thënë avokati Koci, duke përsëritur se nga kjo zvarritje po rrezikohet “shtetësia e Kosovës”. Edhe pjesëtarë të shoqërisë civile kanë protestuar disa herë para ndërtesës së Kuvendit duke i thirrur deputetët në përgjegjësi. Në Kuvendin e Kosovës me 120 ulëse, nevojiten 61 vota për të votuar me sukses emrin e ri të kryekuvendarit. Lëvizja Vetëvendosje, si fituesja e më së shumti votave në zgjedhjet e 9 shkurtit, i ka 48 ulëse në Kuvend, pasuar nga Partia Demokratike e

Kosovës me 24, Lidhja Demokratike e Kosovës me 20, Lista Serbe me 9 dhe koalicioni mes Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate, me 8 të tilla. Edhe 11 ulëse të tjera janë të pakicave. Vetëm Nisma Socialdemokrate i ka tre deputetë në Kuvend. Përveç Limajt, kjo parti përfaqësohet nga Xhevahire Izmaku dhe Arbëreshë Krasniqi. Ministri në detyrë i Administrimit dhe Pushtetit Lokal dhe kryetari i Iniciativës së re Demokratike të Kosovës (IRDK), Elbert Krasniqi, ka sinjalizuar më parë se shtatë deputetë të pakicave joserbe do të votonin pro konstituimit të Kuvendit të ri dhe një qeverie të re të udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje. Deri më tani deputetët e pakicave, Duda Balje, Veton Berisha dhe Adem Hoxha, kanë thënë se nuk ofrojnë mbështetje pa u plotësuar kushtet e tyre.

## Çitaku: PDK-ja s’e voton asnjë kandidat për kryeparlamentar që ka qenë ministër

Deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka thënë se kjo parti e ka bërë të qartë se nuk e voton asnjë kandidat për kryetar të Kuvendit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje që ka ushtruar funksionin e ministrit. “PDK-ja e ka bërë të qartë qëndrimin e saj rreth konstituimit të Kuvendit: nuk e votojmë asnjë kandidat i cili ka ushtruar funksionin e ministrit. Kemi ofruar kompromis, ndonëse nuk na është kërkuar, për hir të zhbllokimit të situatës”, ka thënë Çitaku. Ajo ka thënë se takimet mes liderëve, përfshirë edhe atë të së shtunës, do të ishin të dobishme sikur të kishin rezultate.



Më tutje, Çitaku ka vlerësuar se Albin Kurti është duke synuar përmbysjen e rendit kushtetues. “162 ditë janë shumë për pensionistin, për mësimdhënësin që ndihet i përbuzur, për mjekët që u mungojnë barnat esenciale, për punëtorët e sektorit privat, për ndërmarrjet, për ndërmarrësit që

po u mbyllen bizneset për shkak të rrymës. Po për kënd nuk janë shumë 162 ditë? Për Albin Kurtin. Sepse për të kjo kohë është pjesë e planit për përmbysjen e rendit kushtetues dhe zhbërjen e ADN-së të shoqërisë tonë. Ai po synon krijimin e një rendi të ri ku nuk ka më norma dhe ambicie kolektive”, ka thënë Çitaku.

REAGIM I KMDLNJ-së

# PUNËTORËT NUK I MBRON SHTETI

Me datë 21 korrik 2025 në Gjakovë në orën 8:15 dy punëtorë të ndërtimtarisë humbën jetën pasi ranë nga një objekt ndërtimi nga kati i dytë. Punëtorët e ndjerë ishin të moshës 50 vjeçare. KMDLNJ-ja shpreh ngushëllime familjarëve të viktimave dhe kërkon hetime të shpejta për rrethanat në të cilën humbën jetën nevojtarë që për të siguruar të ardhura për të mbajtur familjen, detyrohen të punojnë në kushte ekstremisht të pasigurta siç janë temperaturat e larta, orari i stërzgatur, mungesa e pajisjeve mbrojtëse, mosrespektimi i moshës apo edhe i gjendjes shëndetësore. Vdekjet e fundit në vendin e punës kanë marrë përmasa shqetësuese ndërkaq që qeveria po mjaftohet me një reagim thuaja teknik, pa bërë asnjë veprim që këto raste të parandalohen. Qeveria e Kosovës po shpërfillë sindikatat e

pavarura, qoftë duke mos i përkrahur materialisht, qoftë duke injoruar rekomandimet që po të zbatoheshin do të ndikonin në parandalimin e këtyre rasteve. Qeveria e Kosovës nuk ka bërë asgjë për ta forcuar punën e Inspektoratit të Punës që ka mandat ligjor të monitorojë kushtet e punës të punëtorëve, madje e ka penguar punën duke shkarkuar drejtues në baza politike dhe duke emëruar drejtues tjerë, gjithashtu në baza partiake dhe politike. Në rrethana të vështirësuar për të punuar në kushte të sigurta dhe ku jeta iu rrezikohet çdo ditë, të pambrojtur nga shteti, punëtorëve nuk iu mbetet asgjë tjetër përveç që përmes protestave të kërkojnë kushte më të mira për punë. Është joserioze dhe pa asnjë sens që pas gjitha këto jeta të humbura, të merremi vetëm me ndonjë reagim duke mos



mbështetur punëtorët që punojnë në rrethana shumë të rënda. KMDLNJ-ja do të përkrahë çdo

protestë të punëtorëve që kërkojnë kushte më të mira të punës, si njëra ndër të drejtat elementare të njeriut. Me

mosveprim të qeverisë, punëtorëve kosovarë po iu rrezikohet e drejta kryesore e njeriut, e drejta për jetë.

## RASTI I VDEKJES SË 27-VJEÇARIT NË LIPJAN, APELI KTHEN NË RIVËNDOSJE ÇËSHTJEN KUNDËR PESË POLICËVE



PRISHTINË, 21 KORRIK - Gjykata e Apelit e Kosovës ka njoftuar se ka aprovuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve I. N., A. R., A. K., L. Rr. dhe E. B. si dhe sipas detyrës zyrtare ka anuluar aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, PPr. nr. 41/2025, të datës 09.07.2025, duke e kthyer çështjen në rigjykim. Gjykata Themelore në Prishtinë, Dega në Lipjan - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin PPr. nr. 41/2025, të datës 09.07.2025, të pandehurve të lartcekur ua ka caktuar masën e paraburgimit në kohëzgjatje prej një muaji për shkak të dyshimit se kanë kryer veprën penale vrasje nga pakujdesia të Agon Zejnullahut, 27-vjeçarit nga Lipjani. “Gjykata e Apelit e Kosovës i ka aprovuar ankesat e mbrojtësve të të pandehurve I. N., A. R., A. K., L. Rr. dhe E. B., si

dhe sipas detyrës zyrtare ka anuluar aktvendimin e lartcekur, duke e kthyer çështjen në rigjykim. Kolegji gjykues ka konstatuar se aktvendimi i ankimuar përmban shkelje të dispozitave të procedurës penale të cilat kushtëzojnë anulimin e tij. Gjykata e Apelit ka vlerësuar se aktvendimi i ankimuar nuk përmban analizën dhe vlerësimin e provave relevante, të besueshme dhe me fuqi provuese për të konstatuar dhe për të vërtetuar se ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit kanë kryer veprën penale për të cilën pretendohet. Andaj, në aktvendimin e Gjykatës së Apelit i është propozuar gjykatës së shkallës së parë t'i evitojë të gjitha shkeljet e konstatuara në aktvendimin e ankimuar, duke e kthyer çështjen në rivendosje”, ka njoftuar Gjykata e Apelit.

## Dy persona të vdekur pas rrëzimit nga një objekt ndërtimi në Gjakovë

GJAKOVË, 21 KORRIK - Dy persona kanë vdekur në mëngjesin e së hënës në Gjakovë ka bërë me dije Policia e Kosovës. Sipas raportimeve të medieve lokale, viktimat janë përshkruar punëtorë ndërtimtarie. Zëdhënësi i Policisë së Kosovës për rajonin e Gjakovës, Sheremet Elezaj, ka thënë se viktimat kanë rënë nga një lartësi e objektit që ka qenë duke u

ndërtuar dhe nuk kanë mundur t'i përballojnë plagët e marra. Lidhur me këtë rast, polica ka njoftuar se ka ndaluar dy persona për 48 orë. Në të kaluarën udhëheqës të Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) janë shprehur të shqetësuar me, siç kanë thënë, kushtet e rënda me të cilat përballen punëtorët e ndërtimtarisë në punë. Në Ligjin për Siguri dhe

Shëndet në Punë theksohet se siguria, trajnimi i punëtorëve, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe makinerive janë obligime që duhet t'i zbatojë secili punëdhënës për të punësuarit e tij. Sipas raportit të Inspektoratit të Punës për vitin 2024, vitin që kemi lënë pas janë regjistruar shtatë raste të vdekjeve në vendet e punës.



# 5 PËR QIND MË SHUMË RASTE ME KANCER ÇDO VIT NË KOSOVË



**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Në Kosovë numri i rasteve të reja me kancer po rritet me një ritëm rreth 5 për qind çdo vit, ka bërë me dije drejtori i Klinikës së Onkologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, Ilir Kurtishi. Ai ka shpjeguar se ky trend është rezultat i disa faktorëve, përfshirë ndotjen e ajrit, duhanpirjen apo dietat e paekuilibruara, por edhe ndërgjegjësimi në rritje i qytetarëve për kryerjen e kontrolleve të rregullta. Sipas regjistrit klinik të kancerit në Klinikën e Onkologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, nga janari deri në fillim të korrikut 2025 janë regjistruar rreth 1 070 raste të reja me kancer. Të dhënat në nivel kombëtar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) tregojnë se gjatë dekadës së fundit numri i

rasteve të reja ka ndjekur një trend pothuajse të pandërprerë rritjeje. Kurtishi ka theksuar se një pjesë e konsiderueshme e rasteve vazhdojnë të diagnostikohen në faza të avancuara të sëmundjes. Ai ka përmendur disa faktorë shtesë që ndikojnë në përhapjen dhe përparimin e saj: “Infeksionet me viruse, përdorimi i substancave kontrceptive, mungesa e aktivitetit fizik e të tjera”. Organet e sistemit tretës - si zorra e trashë apo stomaku - janë ndër më të cenueshmet nga tumoret malinje, siç njihen ndryshe format e kancerit. Tumoret në gji dhe në organet gjenitale janë, po ashtu, ndër më të përhapurat. Në një përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) bën me dije se gjatë vitit 2024 llojet

më të përhapura të kancerit kanë qenë: kanceri i gjirit me 640 raste (17.6 për qind), pasuar nga kanceret e tjera të lëkurës me 587 raste (13.8 për qind), ai i mushkërive dhe bronkeve me 312 raste (8.6 për qind) dhe kanceri i zorrës së trashë me 193 raste (5.3 për qind). Në total, gjatë periudhës janardhjetor të vitit 2024 u raportuan 3 644 raste të reja me sëmundje malinje. Sipas statistikave, 51.8 për qind e të prekurve janë gra dhe 48.2 për qind burra, ndërsa grupmosha më e atakuar është ajo mbi 60 vjeç. Prevalenca që tregon se sa persona jetojnë me kancer në një kohë të caktuar - ishte 288.3 raste për 100 mijë banorë në vitin 2024, ndërsa incidenca - që mat rastet e reja të diagnostikuara gjatë vitit - arriti në 227.4 raste për 100 mijë banorë, tregojnë të dhënat e

IKShPK-së. Sipas këtij instituti, rritja e rasteve me kancer lidhet me faktorë të ngjashëm si në vendet e tjera: ndryshimet demografike, ndotja mjedisore, mënyra e jetesës, përmirësimi i diagnostikimit dhe raportimit, si dhe mungesa e programeve të posaçme për parandalim dhe zbulim të hershëm. Në pesë vjetët e fundit trajtimi i pacientëve me kancer në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës është shtuar dukshëm. Megjithatë, kapacitetet e Klinikës së Onkologjisë nuk duket se kanë mundur ta përballojnë në mënyrë adekuate këtë rritje. Kushtet në këtë klinikë vazhdojnë të jenë të kufizuara - qoftë në hapësirë, personel apo pajisje. Aty janë gjithsej 110 shtretër për pacientët që marrin kimioterapi. “Radio Evropa e Lirë” ka raportuar më herët se

ky trajtim ofrohet shpesh edhe në salla të improvizuara. Gjithashtu, pacientët përballen shpesh me pritje të gjata në mungesë të kapaciteteve - qoftë në mjekë, apo barna. Stafi mjekësor thekson vazhdimisht nevojën për investime më të mëdha, të cilat edhe bëhen, por shpesh nuk mjaftojnë për ta përmirësuar ndjeshëm cilësinë e trajtimit apo për ta zbutur fluksin në rritje të pacientëve. Sipas një raporti të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, të publikuar vitin e kaluar, rreth 1 në 5 persona zhvillon kancer gjatë jetës dhe afërsisht 1 në 9 burra dhe 1 në 12 gra vdesin nga kjo sëmundje. Kurtishi ka theksuar rëndësinë e kontrolleve sa më të rregullta, duke vlerësuar se diagnostikimi i hershëm i çdo sëmundjeje rrit ndjeshëm shanset për trajtim të suksesshëm.

## MPJD-ja, mërgimtarëve: Mos udhëtoni me dokumente pa afat

**PRISHTINË, 21 KORRIK** - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) ka kërkuar nga mërgimtarët të mos udhëtojnë me dokumente që kanë afat të skaduar. “Disa shtete gjatë tranzitit kërkojnë dokumente të vlefshme udhëtimi, pa përjashtim. Udhëtimi me dokumente të skaduara nuk lejohet nëpër

territoret e këtyre shteteve, pavarësisht nga praktikat e vendit ku nis udhëtimi. Duke iu referuar rasteve të fundit të paraqitura gjatë kalimeve tranzit, veçanërisht nëpër territorin e Italisë, theksojmë nevojën që qytetarët të verifikojnë paraprakisht kërkesat për dokumentacion për secilin vend që kalojnë

gjatë udhëtimit të tyre. Lusim qytetarët që të planifikojnë udhëtimet e tyre me kujdes dhe të informohen për kushtet e kalimit nëpër secilin shtet përmes të cilit udhëtojnë. Në raste pasigurie, ju ftojmë të kontaktoni misionet tona diplomatike dhe konsullore për udhëzime shtesë”, është thënë apelin e MPJD-së.



# KOSOVA JASHTË LISTËS SË SHTETEVE TË BRISHTA, ÇFARË DO TË THOTË PËR EKONOMINË?

PRISHTINË, 21 KORRIK - Brenda më pak se dhjetë ditësh dy nga institucionet më të mëdha financiare ndërkombëtare, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), kanë hequr Kosovën nga Lista e Shteteve në Situata të Brishtësisë dhe Konfliktit.

Pas më shumë se 15 vjetësh në këtë listë, Kosova kthehet tani në hartën e vendeve që konsiderohen institucionalisht më të qëndrueshme dhe financiarisht më të konsoliduara. Si për Bankën Qendrore të Kosovës ashtu edhe për Qeverinë në detyrë, kjo është një “njohje e rëndësishme e përparimit institucional dhe ekonomik të vendit”. Ekspertët e ekonomisë kanë thënë se ky zhvillim mund ta forcojë imazhin e Kosovës si një vend i qëndrueshëm dhe i besueshëm për investitorët dhe partnerët ndërkombëtarë.

Mejdi Bektashi, profesor i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se vendimet e Bankës Botërore dhe të FMN-së për ta hequr Kosovën nga

Lista e Shteteve në Situata të Brishtësisë dhe Konfliktit janë stimuluese për zhvillimet e ardhshme ndaj të cilave Kosova duhet të përshtatet. Sipas tij, Kosova tani e tutje do të ketë përfitime të shumta jo vetëm nga Banka Botërore dhe FMN-ja si institucione financiare, por edhe nga tregjet e tjera financiare që veprojnë në shtetet më të zhvilluara. “Kryesisht, duke rritur qasjen në kreditim, në zvogëlimin e normës së riskut, që nënkupton zvogëlimin e normës së interesit, me të cilën Kosova mund të marrë hua apo kredi nga këto institucione apo tregje të tjera financiare”, ka thënë Bektashi për “Radion Evropa e Lirë”.

Ndërsa për profesorin tjetër të ekonomisë, Berim Ramosaj, heqja e Kosovës nga Lista e Shteteve në Situata të Brishtësisë dhe Konfliktit rrit besimin e investitorëve vendorë e të huaj, zgjeron mundësitë për kredi më të favorshme si në nivel nacional ashtu edhe ndërkombëtar dhe ua jep shansin edhe bankave të rendit të dytë dhe të tretë të

performojnë më mirë.

Bektashi ka thënë se mbështetja nga Banka Botërore dhe FMN-ja siguron stabilitet makroekonomik për Kosovën, duke përfutur jo vetëm sektori publik, por edhe ai privat, i cili do të ketë qasje më të lehtë dhe me kushte më të favorshme në huazime nga vendet e zhvilluara. Megjithatë, ai ka theksuar se pjesa më e madhe e aktivitetit financiar në Kosovë lidhet me Bashkimin Evropian, i cili prej dy vjetësh ka vendosur masa shtrënguese ndaj vendit për shkak të tensioneve në veri. Ai ka shtuar se vendimet e Bankës Botërore dhe FMN-së duhet të shërbejnë tani si sinjal pozitiv edhe për vetë BE-në që t’i heqë masat shtrënguese dhe të adoptojë një qasje më të moderuar ndaj Kosovës.

Më tutje, ai ka thënë se vendimet e Bankës Botërore dhe FMN-së për Kosovën janë një “karotë stimuluese”. Ai ka vënë në dukje se në Kosovë ka ende ndërhyrje politike në sistemin e drejtësisë, gjë që e vë në pikëpyetje garantimin e vendimeve të



drejta. Bektashi ka thënë se deficitit tregtar mbetet i lartë, ndërsa politikat ekonomike të qeverisë në detyrë nuk kanë sjellë përmirësimet e pritshme. Ramosaj ka vlerësuar, gjithashtu, se meritë për këtë vendim ka Banka Qendrore e Kosovës. Ai ka thënë se Kosova ka bërë përparime në qëndrueshmërinë ekonomike dhe institucionale, por se, në thelb, realiteti ekonomik dhe ai politik nuk janë ende plotësisht të qëndrueshëm. Ramosaj i është referuar faktit se Kosova ende nuk ka arritur ta konstitudojë Kuvendin e ri edhe pse zgjedhjet janë mbajtur më 9 shkurt për shkak të mosmarrëveshjeve politike dhe, për pasojë, funksionon me qeveri në detyrë. Pavarësisht

kësaj, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, e ka përshkruar daljen e Kosovës jashtë Listës së Shteteve të Brishta si rezultat i “punës së vazhdueshme dhe të përkushtuar” të qeverisë së tij gjatë katër vjetëve të fundit. Bektashi ka thënë se nuk beson se Kosova mund të rikthehet në gjendjen që ishte sa i përket trajtimit nga Banka Botërore dhe FMN-ja. Sipas tij, vendimmarrjet në këto dy institucione financiare “janë shumë të ndërlikuara për t’u kthyer pas”. Edhe Ramosaj ka ndarë të njëjtin mendim, duke theksuar se vendimet e Bankës Botërore dhe FMN-së për Kosovën janë rezultat i një procesi të kujdesshëm dhe të gjatë. Të dy ekspertët kanë rekomanduar se Kosova do të vazhdojë t’i forcojë institucionet dhe të zbatojë politika të qëndrueshme ekonomike, duke ndjekur me kujdes sugjerimet e Bankës Botërore, FMN-së dhe partnerëve ndërkombëtarë, për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të besimit të investitorëve.

## EKONOMISTËT: KOSOVA TA HEQË TAKSËN NDAJ SHBA-së, DËMTON EKONOMINË DHE MARRËDHËNIET DIPLOMATIKE

PRISHTINË, 21 KORRIK - Njohës të ekonomisë në Kosovë janë duke kërkuar me ngulm heqjen e menjëhershme të taksës prej 10-përqindësh ndaj importeve nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), duke e cilësuar atë si një veprim të papranueshëm që po dëmton rëndë raportet strategjike dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke e quajtur këtë taksë “të pajustificueshme dhe të dëmshme”, njohësit e zhvillimeve ekonomike kanë theksuar se urgjenca për heqjen e saj nuk është vetëm ekonomike, por edhe politike dhe gjeostrategjike.

Ekonomisti Safet Gërxhaliu ka kritikuar ashpër institucionet vendore për, siç ka thënë, mungesë të vizionit dhe dështim për t’i avancuar proceset ekonomike dhe diplomatike. Ai ka vlerësuar se heshnja e institucioneve të Kosovës dhe mosangazhimi serioz për heqjen e kësaj takse është duke e izoluar gjithnjë e më shumë vendin në aspektin ekonomik, politik dhe gjeostrategjik. “E para, është një

turp i kohës për Kosovën, që një shtet shpëtimtar, një aleat strategjik, siç është ShBA-ja, të jetë e penalizuar me një taksë 10 për qind për importet. E dyta, kjo dëshmon papjekurinë institucionale në Kosovë. E treta, kjo dëshmon që në Kosovë është varrosur definitivisht diplomacia, qoftë politike, në veçanti ajo ekonomike. Dhe nuk mund të pritët diplomaci efektive qoftë në aspektin politik, qoftë në aspektin ekonomik, në qoftë se kemi Ministri të Punëve të Jashtme të mbuluar apo të ngarkuar me politikanë të padijshëm, të cilët vërtet shumë më tepër e dëmtojnë sesa që avancojnë këto procese. Ka qenë një tentativë vetëm më tepër gojore nga presidenca që kjo taksë duhet të hiqet. Mirëpo në realitet nuk ka ndodhur asgjë. Ajo që është më shqetësuese për ardhmërinë e Kosovës është heshnja politike, ekonomike edhe e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e vendeve evropiane, por edhe disa vendeve të Ballkanit Perëndimor”, ka thënë



Gërxhaliu.

Në këtë kontekst, Gërxhaliu ka thënë se është shqetësuese rënia drastike e eksportit nga Kosova në ShBA. “Duhet të jemi falënderues, duhet të jemi mirënjohës, në veçanti ndaj Shteteve Bashkuara të Amerikës që kanë qenë me ne në kohët më të vështira dhe sot e gëzojmë lirinë falë një intervenimi edhe ushtarak, edhe politik, edhe diplomatik. Dhe se sa është impakti në këtë drejtim e dëshmon fakti që para sa viteve Kosova ka arritur të ketë më tepër se 200 milionë euro eksporte në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Sot apo në vitin 2024 është një shifër shqetësuese që janë afro 37 deri në 38 milionë, vlerë e prodhimit ‘Made in Kosova’ dhe e tëra kjo na obligon që vërtet të jemi më

aktivë, të jemi falënderues. Kjo taksë e turpit t’i takojë së kaluarës dhe sa më shpejt që është e mundur të hiqet”, ka thënë Gërxhaliu.

Ndërsa njohësi tjetër i ekonomisë, Mustafë Kadrijaj, ka vlerësuar se Kosova duhet sa më shpejt ta heqë taksën ndaj ShBA-së. “Kosova duhet një hap përpara ta largojë masën ndaj ShBA-së për faktin se si me qenë, si mos me qenë, nuk ndikon fare në raportin ekonomik me ShBA-në, për faktin edhe sikur mos të kemi fare taksa me ShBA-në, i gjithë plasmani, i gjithë produkti të plasohet në ShBA, nuk mundet as për disa minuta të mbajë gjallë konsumin dhe ekonominë e ShBA-së. Duke e ditur rrugëtimin tonë si Kosovë, vlerësoj se Qeveria e Kosovës një hap përpara duhet ta largojë taksën dhe masat ndaj ShBA-së”, ka thënë Kadrijaj.

Për këtë çështje “Kosovapress” u ka dërguar pyetje Presidencës dhe Qeverisë së Kosovës, mirëpo nuk janë përgjigjur deri në publikimin e këtij artikulli. Eksportet e Kosovës drejt

Shteteve të Bashkuara të Amerikës kanë pësuar rënie gjatë pesëmujorit të parë të vitit 2025 në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2024. Sipas të dhënave zyrtare, nga janari deri në maj 2025 Kosova ka eksportuar drejt ShBA-së rreth 10.04 milionë euro, ndërsa në pesëmujorin e parë të vitit 2024 kjo shifër ishte rreth 23.79 milionë euro. Pra, një tkurrje prej 57.8-përqindësh në më shumë se 13.7 milionë euro më pak mallra të eksportuara drejt ShBA-së. Importet e Kosovës nga ShBA-ja kanë shënuar një ulje në pesëmujorin e parë të këtij viti krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave zyrtare të tregtisë së jashtme, nga janari deri në maj 2025 Kosova ka importuar nga ShBA-ja mallra me vlerë rreth 322 milionë euro, ndërsa në pesëmujorin e parë të vitit 2024 kjo vlerë ishte rreth 356 milionë euro. Ky ndryshim përfaqëson një tkurrje prej 9.55-përqindësh, pra në rreth 34 milionë euro më pak mallra të importuara nga ShBA-ja në tregun e Kosovës.

### Dogana tejkalon 1 miliard euro të hyra, rritje prej 9.7-përqindësh me vitin e kaluar

PRISHTINË, 21 KORRIK - Dogana e Kosovës ka shënuar sukses të rëndësishëm fiskal duke mbledhur mbi një miliard euro të hyra deri në javën e tretë të korrikut 2025, që përfaqëson një rritje prej 9.7-përqindësh

krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Në vitin 2024 në këtë periudhë ishin mbledhur 912 milionë euro, ndërsa këtë vit tejkalimi është konsiderueshëm edhe ndaj planit vjetor të paraparë.

Sipas njoftimit të Doganës së Kosovës, ky rezultat është dëshmi e qartë e përmirësimeve strukturore dhe efikasitetit në menaxhim, përkundër faktit se “politikat fiskale efektive në norma tatimesh janë ulur

ndjeshëm”. “Stafi ynë mbetet shtylla kryesore e këtij suksesi. Me përkushtimin e tyre të vazhdueshëm, ata sigurojnë rezultate që i shërbejnë drejtpërdrejt publikut”, ka njoftuar dogana.



# LESHRAT E ARIANIT KOCIT!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Reagim ekstrem kundër.... bukurisë: Janë dy persona që po reagojnë kundër bllokimi të Kuvendit të Kosovës nga keqbërësi Kurthi, i shoqëruar nga dy marioneta hiperaktive, marioneta numër 1 që është “kryetar” i Kuvendit dhe marioneta numër 2 që po kacavirret të bëhet kryetare e Kuvendit; Avni Dehari dhe Lenka Haxhiu. Opozita nuk është se po tregon një vullnet a gatishmëri të tejkalimit të situatës përmes ofrimit të një konstruktiviteti kushtëzues.

PDK-ja nuk e voton asnjë të propozuar nga Kurthi që ka qenë pjesë e qeverisë në ndërkohë që i voton 40 emra të tjerë. Këtu nuk shoh asnjë logjikë as politike e as jopolitike për faktin se ata 40 të tjerë nuk dallojnë asgjë nga këta 8 të tjerë për faktin se të gjithë janë formatizuar dhe klonuar nga Albin Kurthi. Merreni me mend nëse propozohen injorantët legjendarë si Gima i Gushavcit, kumbara i Spasiqëve, ofruesja e dashurisë, një leshko si Dilmali, narkomanët e Prizrenit

dhe trabantët tjerë “intelektualë”, këta do të votoheshin nga PDK-ja!!!! Në lojën e pokerit parapolitik, PDK-ja po luan bllofin duke e ditur se Kurthi nuk e ndërron propozimin me emër tjetër të LV-së andaj po i kërkon 40 “yje” tjera për t’i votuar. PDK-ja është dashur që në seancën e parë ta votojë të propozuarin/të propozuarën nga LV-ja për të krijuar epërsi strategjike për zgjedhjet lokale në vjeshtë dhe zgjedhjet e përgjithshme, kurdo që ato do të mbahen. AAK-ja është më modeste duke ofruar tre emra që do të votoheshin, Glauk Konjufca, Shqipe Selimi dhe Saranda Bogujevci. Që të tre të “propozuar” nga AAK-ja kundërshtuan vullnetin, pa asnjë legjitimitet të AAK-së, duke e përkrahur Lenka Haxhiun. Këta 47 deputetë të LV-së, të fotokopjuar nga Xeroxi (fotokopjuesi) i Kurthit ndryshojnë qëndrim vetëm nëse Kurthi do të ndryshojë qëndrim. Në këtë mes qëndrim më të drejtë dhe më të sinqertë, nëse marrim guxim të themi se në politikën kosovare ka sinqeritet, ka LDK-ja që kanë deklaruar se nuk e votojnë asnjë të propozuar nga LV-ja për kryetar Kuvendi. Ky qëndrim do të përkthehet në rritje të votave për LDK-në, pa asnjë dyshim. Test i parë do të jenë zgjedhjet lokale. Gjykata Kushtetuese e Kosovës e ka ngatërruar lëmshin edhe më shumë duke krijuar rrethana që secili ta interpretojë sipas dëshirës dhe nevojës. Presidentja e Ukrainës, Vojsa Osmani po

mundohet ta demonstrojë atë që nuk e ka dhe që e ka lënë peng te Albin Kurthi, paanësinë, të qenit përbashkues, autoritetin dhe mandatin e garantuesit të funksionimit normal të institucioneve. Po kush atëherë po angazhohet për zhbllokim të ngërçit për një Kuvend funksional?

1. Ambasadori i Gjermanisë, aktivisti i devotshëm, por i padeklaruar publikisht, herrnRohde.
2. Shoqëria civile me do protesta që nuk e bindin askënd. Pastaj këta nuk i merr askush seriozisht për faktin se mendohet, në publik se punojnë vetëm për lekë.
3. Fatmir Limaj me kusht që ai të bëhet kryetar i Kuvendit.
4. Grupi i besnikëve të pakicës joserbe, me kusht që ta marrin ndonjë ministri, tender a ndonjë përfitim tjetër.
5. Prof.dr. Ramçe i njohur si baba i mediokritetit, injorancës, pafytyrësisë dhe servilizmit në Kosovë. Ai është i dashuruar marrëzisht në patriotizmin e Fatmir Limajt, nëse voton siç do Kurthi. Çfarë alkimie, dje Fatmir Limaj quhej Fatmir Asfalti, sot Fatmir patrioti.

Mendoj se janë vetëm dy personalitete që angazhohen sinqerisht, madje duke kontribuar me mjete vetjake, materiale dhe jomateriale përfshirë këtu sakrificën sublime.

1. Agim Pllashniku: një ish-ushtar i UÇK-së dhe mbrojtës i vlerave të luftës çlirimtare në me

krye Hashim Thaçin, Kadri Veselin, Jakup Krasniqin dhe Rexhep Selimin. Protestoi shumë herë, pa siguruar përkrahje të gjerë, përveç lavdërimit. Së fundi, para Kuvendi solli dy shalqinj që kanë kushtuar afërsisht 10 euro. Me ato para ka mundur të blejë “koçet e dashit” te ndonjë mishshitës patriot e që pastaj t’i varë në dyert e Kuvendit. Ashtu po veprojmë ne votuesit duke ngarë: “sikur Muça, pas daive...”.

2. Arianit Koci e filloi kundërshtimin “si Mohikan i fundit”. Herë me intervista, herë duke qortuar deputetët duke mos i lënë të flasin para Kuvendit. Pastaj me pyetje papnore, “Urbi et Orbi” drejtuar qytetarëve nëse do të përkrahej nëse do të angazhohej në politikë. Çka ka bërë deri më tani përveç promovimit politik?! Pastaj solli katër gomarë nga Istogu duke e përjashtuar në mënyrë diskriminuese përfaqësimin rajonalë. Madje njërit, më të voglit “anakonda” i mbërriti përtokë. Prishtina është qytet i mundësive të mëdha, edhe për gomarin adoleshent nga Istoku. Sot Arianiti paralajmëroi përshkallëzim sakrifikes, pa treguar cili do të jetë. Së pari mendova se mund të sakrifikohet si Jan Pallahu në sheshin “Vasllavskije Namjesti në Pragë”, Çeki që i vuri flakën vetes për të kundërshtuar okupimin sovjestik. Për fat të mirë për Kosovën dhe mbarë njerëzimin liridashës Koci nuk e bëri këtë. Ai, thjesht e rrou kokën

duke prerë flokët. Mirë ka bërë, edhe ashtu flokët ishin hapareshur, nuk i rrinin bukur. Me të dëgjuar për këtë rast sublim të sakrificës së Kocit, të paparë dhe të padëgjuar deri më sot, më iku mendja te kënga: “Shtatë shaljanë kanë ra në Shtoj...” përkatësisht pjesa kur Deli Pjetra largohet nga Saraji i Shkodrës për të dhënë lajmin se kanë: “lanë një nam në Shkodër, preun vezirit djaln n’votër...”. Nëna e tij duke menduar se djali i ka tradhtuar shokët i drejtohet me: “ku je bir, ku i ke lanë shoktë, për ty nana i preftë floktë...”. Atëherë prerja e flokëve nënkuptonte akt të lart moral, si përgjigje ndaj tradhtisë. Motivi i Kocit nuk besoj se ka këtë prapavijë, morale në radhë të parë. Së pari Koci nuk është shaljan siç jam unë po duket të jetë një levrek i butë, më herët si pjesë e menysë politike të Albin Kurthit. Tash, meny e kujt është?! Shpresoj se Koci e ka përfunduar sot procesin e rruajtjes, e të mos vazhdojë më tutje. Edhe ashtu jemi bërë gazi i botës. Dikush tha se kjo javë do të jetë javë e pazareve të pista që nuk ka të bëjë me interesin e qytetarit dhe Kosovës. Është vazhdimi i takimeve Kurthi - Limaj. A po bëhet më m.. a, siç thoshte Azem Galica!!!! Dikush tha se kjo javë do të jetë javë e pazareve të pista që nuk ka të bëjë me interesin e qytetarit dhe Kosovës. Është vazhdimi i takimeve Kurthi - Limaj. A po bëhet më m.. a , siç thoshte Azem Galica !!!!!



Avokati Arianit Koci qeth flokët në shenjë proteste për moskonstituimin e Kuvendit



## Ballkani transferon portierin Goluboviq nga Dinamo Bukuresht

Skuadra e Ballkanit ka bërë një lëvizje mjaft të madhe në treguan e transferimeve, pasi e ka transferuar Adnan Goluboviqin nga Dinamo

Bukureshti. “FC Ballkani ka kënaqësinë të njoftojë afrimin më të ri në portë. Gardiani me përvojë Adnan Goluboviq i bashkohet klubit

tonë nga Dinamo Bukureshti! Me një karrierë të ndërtuar në disa kampionate evropiane dhe paraqitje të sigurta mes

shtyllave, Goluboviq vjen për ta forcuar edhe më shumë repartin tonë mbrojtës, duke sjellë siguri, përkushtim dhe profesionalizëm. Objektivi

ynë është i qartë: të synojmë më lart, së bashku! Mirë se erdhe në qytetin e kampionëve, Adnan!”, thuhet në njoftimin e Ballkanit.

# HEDHET SHORTI PËR SEZONIN E RI NË FUTBOLL



### “Epoka e re”

Prishtinë, 21 korrik - Në ambientet e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK) të hënën është zhvilluar ceremonia e tërheqjes së shortit për edicionin e ri të garave në futboll, përkatësisht në Superligë dhe Ligën e Parë. Ceremonia e shortit u mbajt në praninë e përfaqësuesve të klubeve pjesëmarrëse, ndërsa atmosferën e ngrohu shpresa për një sezon të mbushur me duele interesante dhe garë të fortë sportive. Fjalën e rastit e mbajti kryetari i Komisionit të Garave, Abdyl Bellopoja, i cili uroi një edicion të suksesshëm për të gjitha klubet dhe theksoi rëndësinë e organizimit dhe profesionalizmit

gjatë zhvillimit të kampionatit. Ai theksoi se gara e rregullt, “fair-play” dhe përgatitja maksimale janë shtyllat mbi të cilat duhet të ndërtohet suksesi i këtij sezoni. Pas hedhjes së shortit është bërë me dije se sezoni i ri në Superligën e Kosovës do të fillojë më 16 gusht, me ndeshjet e xhiros së parë që do të luhen më 16 dhe 17 gusht. Kalendari i javës së parë premton përballje interesante. Ndërkohë, edhe Liga e Parë, që këtë edicion përbëhet nga 18 skuadra, do ta nisë sezonin në të njëjtën datë. Pritet një garë tepër e fortë për ngjitjen në elitën e futbollit të Kosovës, ndërsa ndeshjet e xhiros së parë sjellin duele mjaft interesante. Me shortin e hedhur dhe datat e konfirmuara, tashmë klubet kanë edhe rreth tri javë kohë për t'u

përgatitur para nisjes së sezonit më 16 gusht.

#### JAVA E PARË NË SUPERLIGË

Dukagjini - Prishtina  
Gjilani - Ballkani  
Malisheva - Prishtina e Re  
Ferizaj - Drita  
Drenica - Llapi

#### JAVA E PARË NË LIGA E PARË

Prizreni - Trepça '89  
Trepça - Istogu  
Ramiz Sadiku - 2 Korriku  
Vëllaznimi - Feronikeli  
Besa Pejë - Vushtrria  
Kika - KEK-u  
Suhareka - Vjosa  
Dinamo - Tefik Çanga  
Rilindja - Liria

### SHKURT

#### Kosova U20, e teta në Evropian

Kosova U20 te meshkujt është renditur përfundimisht e teta në FIBA U20 Kampionatin Evropian, Divizioni B. Ky ishte suksesi më i madh te grupmoshat e reja që nga pranimi në FIBA. Në sfidën për vendin e shtatë, dardanët e rinj pësuan nga Irlanda 74:47 (24:5, 25:14, 17:12, 8:16). Përballja faktikisht u vendos në pjesën e parë, ku irlandezët ishin më të mirë dhe në pjesën e dytë ruajtën epërsinë e lartë të krijuar. Rron Dahsyla kishte 11 pikë te Kosova. Kujtojmë se dardanët kishin tri fitore radhazi në grup, duke mundur Suedinë, Shqipërinë dhe Hungarinë, derisa pësuan nga Turqia. Në çerekfinale pësuan nga Zvicra, më pas për vendet 5-8 nga Britania e Madhe.

#### Beqiri, delegat i EHF-së në Kampionatin Evropian U19 në Podgoricë

Delegati i ndeshjeve i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eshref Beqiri, kishte periudhë shumë të ngarkuar në Podgoricë të Malit të Zi. Beqiri ishte delegat i Federatës Evropiane të Hendbollit në Kampionatin Evropian për hendbollistet deri në 19 vjet. Evropiani nisi më 9 korrik, ndërsa përfundoi të dielën. Beqiri ishte delegat në shumë ndeshje të rëndësishme, duke përfshirë edhe gjysmëfinalen mes Austrisë dhe Spanjës. Me delegimin e Beqirit në Evropianin e 19-vjeçarëve vetëm është konfirmuar besimi i madh që EHF-ja ka në zyrtarët e ndeshjeve të Federatës së Hendbollit të Kosovës.

#### Edhe West Hami në garë për Xhakën

West Ham Unitedi është ekipi i fundit që ka shprehur interesim të madh për transferimin e shqiptarit Granit Xhaka. Madje thuhet se klubi anglez është i vendosur për t'i mposhtur skuadrat e tjera që janë në garë për mesfushorin 32-vjeçar, pasi tashmë ka bërë gati ofertën për shërbimet e tij. West Hami është i gatshëm të ofrojë deri në 15 milionë euro, çmim që Bayer Leverkuseni po e kërkon për kartonin e Xhakës, i cili ka kontratë deri në vitin 2028. Ditët e fundit interesimi për Xhakën është rritur dukshëm, sidomos nga Sunderlandi, Interi dhe Fenerbahçe, por në këtë garë nuk mungojnë as Crystal Palace, Nottingham Foresti, Fulhami, Juventusi dhe Milani. Javën e shkuar ekipi nga Arabia Saudite, Neom, u tërhoq nga gara për Xhakën shkaku i kërkesës së Leverkusenit.

## Sukses historik, Kosova U19, e pesta në Evropianin në Gjeorgji

PRISHTINË, 21 KORRIK - Përfaqësuesja U19 e Kosovës në hendboll e ka përfunduar të dielën paraqitjen në Kampionatin Evropian në Telavi të Gjeorgjisë. Hendbollistet e Kosovës U19 përfunduan në pozitën e pestë të Evropianit B, që është suksesi më i madh i ekipeve tona kombëtare për grupmosha të reja në kampionate kontinentale. Kosova U19 e përfundoi

Kampionatin Evropian B me katër fitore dhe dy disfata. Në fazën grupore vajzat tona fituan bindshëm ndaj Bullgarisë dhe Gjeorgjisë, ndërkohë pësuan nga Ukraina dhe Sllovakia, finalistet e Evropianit. Vetëm në pjesën e dytë të ndeshjes ndaj Ukrainës paraqitja e Kombëtares sonë nuk ishte në nivelin e pritur. Me Sllovakinë vajzat tona luajtën ndeshje të fortë dhe të

barabartë, ndonëse pësuan në fund. Pasi u mungoi fati për kualifikim në gjysmëfinale, hendbollistet tona të reja shënuan dy fitore për të përfunduar në pozitën e pestë. Fillimisht fituan 35:26 ndaj Izraelit e të dielën fituan edhe ndaj Luksemburgut. Në ndeshjen ndaj Luksemburgut, Kosova U19 fitoi me rezultat 25:21. Arjeta Imeraj ishte më efikasja



me 7 gola. Nga 4 i shënuan të gjitha lojtarët dhanë kontribut Orgesa Gola e Diona Dresh, por në fitoren e rëndësishme.

## Kapiteni i Club Brugges, Milanit: Paguani 40 milionë euro dhe merreni Jasharin

Bruges, 21 korrik - Telenovela e merkatos mes Ardon Jasharit dhe AC Milan vazhdon të zërë faqet e para në Belgjikë dhe Itali. Pas mungesës së mesfushorit zviceran në Superkupën e fituar nga Club Brugge ndaj Union Saint-Gilloise (2-1), kapiteni i ekipit, Hans Vanaken, ka komentuar situatën me tone ironike dhe

të drejtpërdrejta. “E kuptoj Jasharin. Edhe unë do të doja të shkoja në Milano në moshën e tij. Nëse Milani do ta dojë vërtet, le të paguajë 40 milionë euro dhe do ta kalojmë këtë histori”, ka deklaruar Vanaken për “Dazn”. Ai ka shtuar se ekipi është i gatshëm ta mirëpresë sërish lojtarin nëse kthehet në stërvitje, por theksoi se

Brugge nuk mund të mbetet peng i dëshirave personale: “Nëse nuk dëshiron të luajë për ne, do ta përballojmë. Jeta vazhdon”. Trajneri Nicky Hayden konfirmoi se Jashari duhet të kthehet në stërvitje të hënën, ndërsa shprehu besim se klubi do ta menaxhojë siç duhet situatën, edhe pse e cilësoi

atë si të ndërlikuar. Për momentin gjithçka varet nga Milani dhe gatishmëria e tij për ta përmbushur kërkesën financiare të Brugges, që kap vlerën e 40 milionë eurove. Jashari mbetet objektiv i qartë i kuqezinjve, por konkurrenca dhe çmimi mund të bëhen pengesa serioze për realizimin e transferimit.



## Berisha konfirmon bisedimet për rikthim në Itali

GOTHENBURG, 21 KORRIK - Pas eliminimit të Spartak Trnavës në turin e parë të Ligës së Evropës, klubi suedez Hacken ka përqendruar vëmendjen te situata e portierit shqiptar Etrit Berisha i cili po kalon një formë të shkëlqyer. Gardiani kuqezi ka zbuluar më herët se kontrata e tij përfshin një klauzolë që i jep të drejtën të largohet gjatë kësaj vere, një mundësi që mund të konkretizohet, duke qenë se për të ka interesim konkret nga skuadra italiane. Megjithatë, Berisha mbetet i kujdesshëm në deklaratat. “Asgjë nuk është e sigurt ende. Do të shohim çfarë ndodh. Siç thashë, kemi filluar të flasim, kemi edhe pak kohë deri në fund të korrikut dhe pastaj do të shohim. Ka pasur disa kontakte në Itali, por është



agjenti im që merret me këtë. Për mua është e rëndësishme të përqendrohem këtu”, ka theksuar portieri 35-vjeçar. Në kampin suedez, Hacken nuk e fsheh dëshirën për ta mbajtur Berishën edhe përtej këtij sezoni. Drejtori sportiv i klubit,

Martin Erikson, e bëri të qartë synimin e klubit për ta rinovuar bashkëpunimin me shqiptarin: “Ne do të dëshironim shumë që ai të qëndronte më gjatë sesa deri në fund të sezonit. Kemi pasur bisedime me të për këtë”, ka deklaruar Eriksoni.

## Hamiltoni: Dua që ADN-ja ime të ndihet te Ferrari

LONDËR, 21 KORRIK - Lewis Hamiltoni ka thënë se dëshiron të ketë “disa nga ADN-ja ime” në makinën e Ferrari për vitin 2026. Shtatë herë kampioni i botës në Formula 1 ka pasur vështirësi në sezonin e tij të parë me “kokëkuqen”, ende pa asnjë podium këtë sezon, ndërkohë që shoku i tij i skuadrës, Charles Leclerc, ndodhet para tij në renditje dhe ka marrë katër podiume. Gjithsesi, performanca e Ferrari në përgjithësi këtë vit ka qenë shumë më poshtë pritshmërisë së parasezonit. Një sërë përmirësimesh duket se e kanë përmirësuar SF-25, por Hamiltoni zbuloi planet mbi të cilat po punon me drejtorin teknik të shasisë së Ferrari për të zëvendësuar ato që ai i konsideron si “karakteristika” të padëshiruara të makinës aktuale me elementë që ai i gjen më të favorshëm. “Këtë vit me këtë makinë kemi shumë mjete dhe



mënyra të ndryshme me të cilat mund ta konfigurojmë makinën. Charles ka qenë këtu për një kohë të gjatë dhe ka qenë pjesë e evolucionit dhe zhvillimit të kësaj makine dhe është më shumë i mësuar me të”, ka thënë Hamiltoni. “Ai ka gjetur një mënyrë se si funksionon makina. Kam provuar të gjitha drejtimit e tjera që duhet të funksionojnë, por ato thjesht nuk funksionojnë për çfarëdo arsye. Dhe kam migruar

ngadalë në vendin ku Charles e drejton makinën”, ka shtuar britaniku. “Është ende e vështirë, është një ekuilibër i vështirë për t’u drejtuar. Ndaj po punoj me Loic Serra dhe të gjithë djemtë në fabrikë për t’u siguruar që makina e ardhshme do të ketë disa nga ADN-ja ime. Shpresojmë se do të jemi në gjendje të marrim disa nga karakteristikat që shpresoj të kem në të vitin e ardhshëm”, ka deklaruar Hamiltoni.

### SHKURT

#### Raudondvaris Hoptrans triumfon në FIBA 3x3 Challenger Prishtina 2025

Skuadra nga Lituania ka triumfuar në FIBA 3x3 Challenger Prishtina 2025, ku për dy ditë radhazi në kryeqytet është zhvilluar spektakël i basketbollit 3x3. Pas shumë ndeshjeve interesante, Raudondvaris Hoptrans në finale fitoi ndaj Valencias me shifrat 21:12. Aurelijus Pukelis është shpallur MVP në kryeqytet. Dy skuadrat finaliste si dhe vendi i tretë u kualifikuan në WT Lausanne më 15-16 gusht si pjesë FIBA 3x3 World Tour 2025. Fituesi u shpërblye me 20 mijë euro, vendi i dytë me 15 mijë, i tretë me 11 mijë, i katërti me 8 mijë dhe i pesti me 6 mijë. Turneu u organizua nga Prishtina 3x3, përkrahur nga Federata e Basketbollit e Kosovës. Për dy ditë me radhë kishte spektakël të basketbollit 3x3, po ashtu edhe muzikë, shpërblime dhe shumë befasi për të pranishmit që ishin në numër të madh.

#### Selmani transferohet në Kinë

Astrit Selmani ka vendosur ta vazhdojë karrierën në Azi. Pas largimit nga Dinamo Bukureshti, sulmuesi nga Kosova është transferuar zyrtarisht te Shaanxi Union në Kinë. Selmani ka nënshkruar me skuadrën kineze që garon në Ligën e Parë, niveli i dytë i futbollit profesionist në Kinë. Ai do ta veshë fanellën me numër 9 për sezonin e ri. “Pas negociatave miqësore me lojtarin, Shaanxi Union FC ka arritur një marrëveshje me Astrit Selmanin. Sulmuesi kosovar është bashkuar zyrtarisht me klubin dhe do ta veshë fanellën ikonike me numër 9”, ka njoftuar klubi përmes një komunikate zyrtare. Gjatë këtij afati kalimtar Selmani ka pasur oferta nga disa klube evropiane. Ai ishte në radar të Rijekës në Kroaci, Rakowi dhe Jagiellonias në Poloni, si dhe Kasimpasas në Superligën turke. Megjithatë, 26-vjeçari ka vendosur ta provojë veten në futbollin aziatik, duke zgjedhur një aventurë të re larg Evropës.

#### PSV-ja në garë për transferimin e Brojës

Në garë për Armando Brojën është futur edhe PSV Eindhoven. Në Angli janë të bindur se shqiptari momentalisht ka katër destinacione ku mund të shkojë edhe pse me asnjërin prej klubeve Chelsea nuk ka hapur një tratativë konkrete. Sipas medieve britanike, përveç Parmës, Shtutgartit dhe Lajpcigut, për shërbimet e sulmuesit shqiptar është interesuar edhe ekipi i PSV Eindhoven. Edhe pse Brojës i mungon goli në Premierë Ligë prej vitesh, për herë të fundit festoi në shkurt të 2022-shit, skuadra holandeze mendon se shqiptari do të bëjë mirë në Eredivisie. Sipas medieve angleze, drejtuesit e PSV-së kanë konsideratë për 23-vjeçarin, i cili është familjar me kampionatin holandez pasi luajti për disa muaj si i huazuar me ekipin e Vitesses.

## Maresca: Kupa e Botës për Klube, po aq e rëndësishme sa Liga e Kampionëve

Ekipi i Chelseat hyri në histori, si i pari që fiton Botërorin për klube, turne që u zhvillua këtë verë në Amerikë. Në finale skuadra londineze mundi 3-0 PSG-në,

fituesin e Ligës së Kampionëve. Enzo Maresca, trajneri i Chelseas, pohoi se Kupa e Botës për Klube mund të jetë më e rëndësishme se Liga e Kampionëve në të

ardhmen, duke krahasuar ndryshimin midis dy ligave kryesore të klubeve në botë. Ai u pyet për të ardhmen e Kupës së Botës për klube të organizuar nga FIFA si dhe

evolucionin e saj. “Mendoj se Kupa e Botës për Klube do të jetë po aq e rëndësishme ose edhe më e rëndësishme se Liga e Kampionëve. Pata fatin të isha pjesë e një stafi

trajnerësh te Manchester City që fitoi Ligën e Kampionëve tre vjet më parë. Por, ky Botëror për klube ka të përfshirë klubet më të mira në botë”, ka thënë Maresca.

F1/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE “ PASTRIMI” SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM “Pastrimi” Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM “Pastrimi” SH.A, në Vendimin e datës 18.07.2025 me numër të protokollit 02/01/537 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM “Pastrimi” SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të punës

|                                   |                                                      |
|-----------------------------------|------------------------------------------------------|
| Titulli i vendit të Punës:        | “Punëtor i Higjienes Publike” në KRM “Pastrimi” SH.A |
| Nr. i kërkuar:                    | Dy (2) pozitë, Njësia Operative Drenas               |
| Numri i Referencës:               | NjOD/KJ-19/2025                                      |
| Koeficienti/Paga mujore:          | Niveli XIII                                          |
| Kohëzgjatja e Kontratës së Punës: | Me kohë të pa caktuar                                |
| Periudha Provuese:                | 3 muaj                                               |

1. Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Kryen punët e përcaktuara në urdhëresën e punës nga udhëheqësi;
- Bënë pastrimin e rrugëve sipas urdhëresës në terrenin e përcaktuar në urdhëresë sipas planit Operativ;
- Pëmbushë detyrat në atë mënyrë për të mos penguar komunikacionin apo lëvizjen e qytetarëve;
- Është përgjegjës për përdorimin e kujdesshëm të mjeteve të punës dhe raporton cdo problem lidhur me pamundësinë e kryerjes së punës;
- Kryen edhe punë të tjera që kërkojnë nga udhëheqësi sipas nevojës;
- Për punën e tij I raporton Udhëheqësit të njësisë së higjienes publike.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detyrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ **Arsimimi i kërkuar:** Shkollim i mesëm.
- ✓ **Përvoja e punës e kërkuar:**

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

|                                                                                              |   |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|---|
| Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati                                         | ✓ |
| CV - në                                                                                      | ✓ |
| Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore                                       | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)          | ✓ |
| Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)                                 | ✓ |
| Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)                         | ✓ |
| Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës       | ✓ |
| Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj | ✓ |

6. Mënyra e aplikimit në konkurs:

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Zyret e Burimeve Njerëzore në KRM “ Pastrimi” SH.A.

Të gjitha aplikimet duhet të bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet platformës elektronike; punesimi.krmpastrimi@gmail.com

7. Data dhe ora e saktë e mbylljes së Konkursit Publik;

